



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Ideal Partners" Sh.P.K. të datës 07.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "99 Ndërtimi i ishullit urban Arbëri Pallati i Rinisë" me nr. të prokurimit 616-24-7202-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Ideal Partners" Sh.P.K. të datës 07.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "99 Ndërtimi i ishullit urban Arbëri Pallati i Rinisë" me nr. të prokurimit 616-24-7202-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Ideal Partners" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 07.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "99 Ndërtimi i ishullit urban Arbëri Pallati i Rinisë" me nr. të prokurimit 616-24-7202-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Duke par që projekti i ndërtimit të Ishulli Urban është në perimetrin e mbrojtur të Pallatit të Rinisë ku sipas Udhëzimit Administrativ të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore duhet të jet 50m' larg objektit për Trashëgiminë Kulturore, Kurse siq shihet në Projekt E5.03.6 PERSPEKTIVA kjo ndërhyrje prek strukturën fizike të objektit dhe ndikon në elementet historike ose arkitekturore të tij, ku do duhet të mbrohen dhe ruhen nëpër puthje me ligjet dhe rregulloret për trashëgiminë kulturore. Andaj kërkojmë nga AK qe te behet rishqyrtimi i dosjes”*.

Fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, AK përmes njësisë kërkuese ka përcaktuar kërkesat e domosdoshme për të siguruar ekzekutimin efikas dhe efektiv të kontratës që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Vlen të theksohet se aktiviteti në fjalë i prokurimit ka një rëndësi mjaft të madhe për Kryeqytetin dhe banorët e saj në përgjithësi. Në anën tjetër as parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë argument të ligjshëm sipas të cilido nga kërkesat e DT nuk është në përputhje me LPP. Prandaj pretendimet ankimore janë të pabazuara. Sa i përket shqetësimit të parashtruesit për konzervimin e objektit të pallatit të rinisë me rastin e realizimit të projektit për ishullin urban, duhet cekur se projekti i ishullit urban nuk afekton në asnjë formë kulturore apo arkeologjike objektin e pallatit të rinisë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.08.2024

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.